



Ndërmarrja Hidroekonomike
"Ibër Lepenc" SH.A



Komuna e Drenasit
Municipality of Drenas
Opština Drenas

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

NDËRMARRJES HIDROEKONOMIKE "IBËR LEPENC" SH.A

DHE

KOMUNËS SË DRENASIT

Lidhur me mënyrën e bashkëpunimit për gypin e ujit që gjendet në zonën kadastrale Zabel
i Ultë në parcelën me nr. P-70314029-00523-2 ku po ndërtohet Stadiumi Sintetik

Dej

1. **NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR LEPENC”SH.A**, përfaqësuar nga z.Berat Lushtaku, Kryeshef Eksekutiv (në tekstin e mëtejme N.H “Ibër Lepenc” Sh.A)
2. **KOMUNA DRENAS**, përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

I

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i obligimeve të përbashkëta institucionale duke përfshirë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese.

Realizimi i Projektit për ndërtimin e Stadiumit Sintetik në zonën Kadastrale Zabel i Ultë, ka diktuar nevojën për dislokim të gypit të sistemit të ujitjes së N.H. ”Ibër Lepenc” SH.A.

II

OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët, në funksion të realizimi të qëllimit të përcaktuar në nenin një (1) të këtij Memorandumi marrin përsipër këto obligime të përbashkëta:

1.1. E drejta për të përcjell punimet e realizimit të projektit të dislokimit të gypit në segmentin siç është përcaktuar në projektin e bashkangjitur me këtë memorandum.

1.2. Në bashkëpunim me investitorin/financuesin e ndërtimit të këtij stadiumi sintetik, do të koordinohen në vazhdimësi që realizimi final i projektit të dislokimit të gypit të jetë i realizuar sipas standardeve të pasqyruar në projekt dhe të bëhet plotësisht funksional.



III.

OBLIGIMET E PALËVE

1. N.H “IBËR LEPENC” SH.A.

1.1.N.H “Ibër Lepenc” SH.A. ka të drejtën e qasjes së vazhdueshme në mirëmbajtje të gypit gjatë gjithë kohës sikurse i ka pasur këto të drejta deri më tani.

1.2.Mbështetë realizimin teknik të projektit përmes mbikëqyrjes së tij dhe dhënies së konstruksioneve të nevojshme gjatë realizimit të projektit nën terren.

1.3.Merr përsipër iniciimin dhe zhvillimin e takimeve koordinuese për rekomandime shtesë nëse dalin gjatë realizimit të projektit.

1.4.Në bashkëpunim me Komunën, kujdesen për realizimin e suksesshëm të të gjithë projektit përmes ofrimit të asistencës profesionale, administrative dhe teknike që mund të jetë e nevojshme dhe që është në përgjegjësinë dhe mandatin e saj.

1.5.Në rastë të ndonjë avarije, dëmtimi të gypave në të ardhmen, N.H “Ibër Lepenc” SH.A. nuk merr asnjë përgjegjesi të ndonjë dëmshpërblimi për ndonjë dëm eventual që mund të shkaktohet nga ky gyp për të cilin edhe është arritur ky memorandum. Si dhe intervenimet për sanimin e dëmit i kryen Komuna e Drenasit për deri sa të jene objektet sportive prezent, si dhe përgjegjsin materjale dhe ligjore për dëmet eventuale ndaj paleve të treta i merr Komuna e Drenasit.

2. KOMUNA E DRENASIT

2.1.Komuna e merr përsipër përgjegjësinë e dëmeve eventuale që segmenti i gypit të dislokuar mund të shkaktoj në hapësirën përreth pas kalimit të afat garantues të punëkryesit;



2.2.Në funksion të realizimit të projektit, asiston vazhdimisht teknikisht për realizim sa më të mirë të projektit;

2.3.Në bashkëpunim me N.H “Ibër Lepenc”SH.A, kujdesen për realizimin e suksesshëm të projektit përmes ofrimit të çfarëdo asistence profesionale, administrative dhe teknike që mund të jetë e nevojshme dhe që është në përgjegjësinë dhe mandatin e saj.

IV ZBATIMI

N.H. “Ibër Lepenc” SH.A dhe Komuna, përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime që duhet të ndërmerren në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në këtë Memorandum.

V PLOTËSIM NDRYSHIMI APO SHKËPUTJA EVENTUALE E MEMORANDUMIT

1.Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.

2.Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë mbinatyrore –palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me njëra – tjetrën për veprimet që duhet të ndërmerren.

3.Afati i realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi duhet të arrihet jo më larg se Qershori i viti 2021.

4.Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një aneks marrëveshje me shkrim midis palëve.

5.Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum Bashkëpunimi, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në Memorandum Bashkëpunimi në



të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandum Bashkpunimi të akorduar nga palët e këtij memorandum, do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

VI

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

VII

NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT


Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në katër (4) kopje identike origjinale, nga dy (2) për palët nënshkruese.

VIII

HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Berat LUSHTAKU




Kryeshef Ekzekutiv

N.H. "Ibër Lepenc"



Ramiz LLADROVCI



Kryetar i Komunës së Drenasit

Nënshkruar më 28/05 2021